



Drejtorati për Bujqësi, Pylltari, Inspeksion, Turizëm dhe Zhvillim Rural
Direktoriat za Poljoprivredu, Sumarstvo, Inspekciju, Turizam i Ruralni Razvoj

09.Nr. 320/01-22872/20
Dt. 20.11.2020
Dragash

Duke u bazuar në Rregullorën komunale për Kushtët, Kriterët dhe procedurat e ndarjes së Subvencioneve me Nr. 01.Nr.060/01-31587/1 të datës 24.12.2019, Vendimit të Kryetarit të Komunës Nr. 02Nr.320/1-20458 të datës 27.10.2020, si dhe në bazë të kërkesës së përfaqësuesve të qumështorëve të komunës së Dragashit me nr. te prot. 09/400/04-21574, Drejtorati për Bujqësi, Pylltari, Inspeksion, Turizëm dhe Zhvillim Rural bënë:

FTESË PËR APLIKIM

Ndihmë ekonomike për qumështorët që po përballën me vështërsi të shumta si pasojë e pandemisë Covid-19

Ftohën subjektet afariste: Qumështorët e komunës së Dragashit, të cilët merrën me përpunimin e qumështit se mund të aplikojnë me kërkesa apo projektpropozime për subvencione - pagesa përmes subvencioneve nga ana e komunës.

Qëllimi

Qëllimi i kësaj thirrje është që t'i ndihmohet qumështorëve të regjistruar në Komunën tonë, që të tejkalojn problemet dhe pasojat e shkaktuara nga pandemia Covid19, si dhe rimekëmbjen ekonomike.

Duke e parë situatën ekonomike të shkaktuara nga pandemia Covid19, operatorët ekonomik -qumështorët e komunës sonë janë ballafaquar me probleme të natyrave të ndryshme si : probleme dhe pengesa në shitjen e produkteve të qumështit, krijimin e stoqëve në magazina, dëmtimin e produktëve pengesa në angazhim te stafit punues etj.

Komuna e Dragashit duke analizuar problemët e shkaktuara nga pandemia Covid19 për qumështorët dhe duke u bazuar në kërkesat e vazhdueshme të përfaqësuesve të qumështorëve ka ndarë një fond për mbeshtetje dhe subvencionim në tejkalimin e kësaj shtate të pafavorizuar për këto veprimtari.

Shuma e subvencionit : 50.000 €

Kohëzgjatja e aplikimit : 20-27 / 11 / 2020

Objektivat e thirrjesë

- Ruajtja e vendeve të punës dhe krijimi i vendeve të reja
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit

- Kompenzimi i humbjeve
- Rritja e të hyrave
- Përmirsimi i konkurshmerisë
- Rritja e produktivitetit dhe cilësisë së prodhimit

Kushtet për aplikim:

Kush mund të aplikojë:

- Të jenë shtetas të Kosovës ;
- Të jetë operator ekonomik i regjistruar dhe që vepron në Komunën e Dragashit, të jetë i regjistruar para datës 30/04/2020 dhe atë për aktivitetet e parapara me veprimin e propozuar para aplikimit për subvencionim (certifikata e regjistrimit e marrur para muajit Maj 2020);
- Licenca e marrur nga organet kompetente AUV për të vepruar si qumështore;
- Gjatë periudhës Maj-Tetor të ketë blerë minimum 40000 litra qumësht për përpunim;
- Gjatë periudhës Maj-Tetor të kenë të punësuar 1-9 punëtor.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qumështorët dhe djathorët e komunës sonë të regjistruara dhe licencuara si qumështore të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriterët e parapara nga organet kompetente.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e letërnjoftimit të pronarit të biznesit;
- Konfirmimi bankar i llogarisë së biznesit;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse (certifikata duhet të jetë e re, lëshuar nga ARBK sipas numrit unik identifikues);
- Licenca valide të lëshuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) për të vepruar si qumështore;
- Vërtetimi nga ATK që nuk ka borgje të pashlyera;
- Raportët e deklaruara në ATK për sasinë e qumështit të blerë dhe numrin e punëtorve për 6 muaj (Maj-Tetor) 2020;
- Lista e fermerëve që dorëzojnë qumësht;
- Dëshmi për pagesën e taksave komunale- Vërtetimin e Tatimit në Pronë ;
- Raport financiar i bazuar në shpenzime të kryera gjatë periudhës Maj-Tetor 2020 (fatura të shpenzimeve si: blerja e lëndës së parë, karburantëve, ambalazhit, etj);
- Fletëaplikacioni i nënshkruar se bashku me kërkesën që sqaron për pagesat që janë kryer.

Dokumentet duhet të protokollohen në zyrën e pranimit drejtuar Drejtoratit për bujqësi.

Kjo skemë e subvencionëve do të mbështetë këto veprimtari:

-Përkrahje përpunuesve të qumështit :

1. Qumështorët (grumbullues dhe përpunues të qumështit në djath, jogurt, kos, ajran, etj) ;
2. Qumështore –djathore (përpunuesë të qumështit në djath) ;

Kriterët që duhët t'i plotësojnë qumështorët/aplikuesit:

Përkrahen:

- Qumështorët dhe djathorët e komunës së Dragashit të regjistruara dhe licencuara sipas kriterëve të vendosura nga organët kompetente ;
- Qumështorët-djathorët që kanë blerë-grumbulluar dhe përpunuar qumësht gjashtë muaj prej muajit Maj deri Tetor 2020;
- Qumështorët- Djathorët bazuar në numrin e punëtorve të angazhuar për gjashtë muaj, nga muaji Maj-Tetor 2020 që kanë të punësuar nga 1 deri 9 punëtor.

Aplikantët që nuk përkrahen:

Aplikantë potencialë nuk mund të marrin pjesë në këtë program apo të përfitojnë subvencionim nëse gjenden në ndonjërin prej situatave që renditen si më poshtë:

- Kanë bankrotuar apo janë në mbyllje, janë nën administrim të gjykatave, kanë pezulluar aktivitetet afariste, i janë nënshtruar procedurave në lidhje me këto çështje, ose janë në situata të ngjajshme që lindin nga procedurat e përcaktuara me legjislacion apo rregullore vendore.
- Aplikacioni me dokumentacion jo valid nuk do të mbështetet dhe do të ndëshkohet për mos aplikim në thirrjet e komunës në periudhë tre vjeqare .

MËRNYRA E SUBVENCIONIMIT

Subvencionimi do të bëhet kur komisioni komunal kontrollon dhe vlerëson sipas kriterëve aplikacionet-kërkesat e dorëzuara të qumështorëve bazuar në sasinë e qumështit të blerë dhe përpunuar për gjashtë muajt e fundit të deklaruar në ATK nga muaji Maj deri në Tetor 2020 në vlerë pagese 0.04 deri 0.06 euro për litër qumësht (llogaritet duke u bazuar në buxhet dhe litrat e deklaruar) si dhe numrin e punëtorëve të angazhuar gjatë kësaj periudhe në vlerë pagese 300 euro për punëtorë.

Vlerësimi dhe kontrolli

Vlerësimi dhe Kontrolli do të bëhet nga komisioni komunal sipas kriterëve të vendosura dhe do të mbështetën kërkesat e kompletuara me dokumentacion valid sipas kriterëve të parapara, që garantojnë qëndrueshmëri ekonomike dhe që ndikojnë në tejkalimin e situatës së krijuar nga pandemia Covid 19.



Drejtori
Fejsal Halilović